



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Furnizim dhe vendosje të materialeve për realizimin e eventeve”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**44812400-9 - Mjete dekorative, 45451000-3 - Dekorime;**

VLERA E FONDIT LIMIT:

9,166,000 (nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

c. *Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;*

ç. *Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.1. **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë, fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

*Shënim:* Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

**Për arsye se furnizimet janë shumë specifike (nuk janë produkte të gatshme), kërkohet eksperiencë e ngjashme në realizimin e produkteve të kësaj natyre, për të siguruar Autoritetin Kontraktor për përmbushjen me sukses të kësaj procedure.**

- 2.3.2.** Operatori ekonomik për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës, vërtetuar me listëpagesën e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave;

*Shënim:* Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- 2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar ose me kontratë angazhimi / bashkëpunimi punonjësit e mëposhtëm:

- 2 (dy) specialistë dizenjator grafik;
- 1 (një) punonjës saldator;
- 1 (një) punonjës elektrikist;

Për punonjësit e mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Diplomë ose certifikatë e lëshuar nga organizma të akredituar në Republikën e Shqipërisë;
- Kontratë individuale të punës ose shërbimit të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate;
- Listëpagesa e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave për punonjësit e punësuar nga operatori ekonomik;

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit me të dhënat e detajuara (emër, mbiemër, detyra që do të realizojë, diplomë ose certifikatë, numri, data e lëshimit, institucioni që e ka lëshuar).

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe gërma b, c pika 5, neni 40 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me objektin e prokurimit.

Punonjësit dizajnator grafik pasi të bien dakord me Autoritetin Kontraktor do të realizojnë dizajnin e të gjitha produkteve të kërkuara (lidhur me format, ngjyrat).

Të gjitha produktet në momentin e vendosjes pranë ambienteve të Autoritetit Kontraktor kanë nevojë për saldimin e elementeve të hekurit dhe më pas montimin e elementeve të dekorit.

Punonjësi elektrikist do të realizojë lidhjen e të gjithë ndriçimit (të gjitha produktet kanë elementë elektrike siç janë dritat). Gjatë instalimit të tyre duhet të tregohet kujdes maksimal për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të vizitorëve dhe punonjësve gjatë periudhës që këto dekore do jenë të vendosura në ambientet e Kopshtit Zoologjik.

**2.3.4.** Operatori ekonomik për transportin e mallrave duhet të provojë se disponon në pronësi ose me qera 1 (një) automjet me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton.

- Për mjetin duhet të paraqitet çertifikatë pronësie ose kontrate qeraje e lidhur tek noteri, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi;
- Leje qarkullimi;
- Çertifikatën e kontrollit teknik;
- Siguracionin e mjetit;

Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (shitblerje ose kontrata dhurimi).

Mjetet me qira shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qirasë të përmbajë objektin dhe afatin e

marrjes me qira të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. **Të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit me të dhënat e mjetit, targa, pronësi / qira.**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**2.3.5.** Operatori ekonomik për realizimin e produkteve të kërkuara duhet të provojë se disponon në pronësi ose me qera pajisjet e mëposhtëme:

- 1 (një) makineri ploter me bojra UV;
- 1 (një) makineri për prerje me forma;
- 1 (një) makineri ploter për material adeziv/tekstil;

Pajisjet mund ti ketë në pronësi (vërtetuar me fatura blerje / akte zhdoganimi / pasqyrim në bilanc) ose me qira (vërtetuar me kontratë qiraje).

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. **Të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit me të dhënat e pajisjeve, pronësi / qira, numri i faturave dhe data, nëse në bilanc faqa ku ndodhen..**

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe gërma ç pika 5, neni 40 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Mjeti i kërkuar do të shërbejë për transportin e materialeve dhe produkteve nga magazina/vendi ku prodhohen apo mbahen në ambientet e AK të përcaktuara në DST.

Të gjitha produktet do të prodhohen sipas kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor. Nevojiten makineritë për prerjen e produkteve me format e kërkuara si dhe prerjen e materialeve adezive/tekstile. Produktet do të dizajnohen me ngjyrat sipas kërkesave të Ak.

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se jep garanci për funksionimin normal të elementëve të dekorit gjatë periudhave festive në të cilat do të përdoren.

**2.3.7.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër montimin e elementëve të dekorit gjatë periudhave festive në të cilat do të përdoren si dhe çmontimin e tyre në përfundim të festave dhe sistemimin e tyre me stafin e AK pranë magazinës së institucionit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vetëdeklarojnë se marrin përsipër dhe japin garanci për funksionimin normal të elementëve të dekorit gjatë periudhave festive në të cilat do të përdoren. Për arsye se produktet do të jenë në kontakt 24 orë me agjentët e ndryshëm atmosferikë (diell, erë, shi, lagështi etj), kërkohet garancia që këto produkte për të gjithë kohëzgjatjen që do të vendosen do të jenë të pa dëmtuara dhe do kryejnë funksionin për të cilin janë realizuar.

Operatori ekonomik do të realizojë montimin dhe vënien në funksion të elementëve të dekorit me punonjësit që i janë kërkuar. Në përfundim të eventit çmontimi do të bëhet nga punonjësit e operatorit ekonomik për arsye të vendosjes së tyre në lartësi dhe kontaktit me energjinë elektrike (stafi i AK nuk ka kapacitet teknike dhe njerëzore për realizimin e kësaj procedure). Materialet do të ripërdoren dhe nuk mund të dëmtohen gjatë heqjes, ndaj duhet të sistemohen duke u magazinuar në ambientet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor për ruajtjen e tyre.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, të përkthyer dhe të noterizuara, nëse janë në gjuhë të huaj.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe neni 36, të LPP, si dhe neni 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 252, datë 15.10.2024 për “Ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për realizimin e

*procedurës me objekt: “Furnizim dhe vendosje të materialeve për realizimin e eventeve” , nr. 492/1 prot., datë 15.10.2024, mbajtur procesverbali nr. 492/2 prot., datë 17.10.2024 për “Përcaktimin e specifikimeve në procedurën e prokurimit me objekt: “Furnizim dhe vendosje të materialeve për realizimin e eventeve” (Specifikimet teknike pjesë e shtojcës 6 Formulari i specifikimeve teknike të DST).*

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Furnizim dhe vendosje të materialeve për realizimin e eventeve”** , Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim Znj. Ilva Ymeraj.

**Njësia e Prokurimit:**